

VENDIMET E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

MBLEDHJA Nr.1

1 Korrik 2015, ora 15:00-17:00

Këshilli i Investimeve në mbledhjen e parë të zhvilluar në ambjentet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, pas diskutimeve nga ana e anëtarëve të pikave të axhendës së miratuar paraprakisht, si edhe në bazë të neneve 6 dhe 9 të Rregullores Nr.1 Datë 01 Korrik 2015,

Vendosi:

1. Inkurajon dhe mbështet finalizimin e reformës derregullatore të *Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*, duke rekomanduar respektimin me përpikmëri të afateve kohore si edhe koordinimin e aksioneve në këtë drejtim për të patur sa më pak risk dhe kosto për biznesin.
2. Të miratojë Rregulloren e brendshme “Për Funksionimin e Këshillit të Investimeve” si edhe logon, të përgatitura nga Sekretariati.
3. Të miratojë metodologjinë e punës së Këshillit të Investimeve.
4. Të miratojë Axhendën për mbledhjet e ardhshme të parashikuara në datat 30 Shtator 2015 dhe 15 Dhjetor 2015 sipas çështjeve të mëposhtme:
 - **Mbledhja Nr. II - 30 Shtator 2015** – Diskutime mbi draft-ligjin “Për Falimentimin në RSh” dhe Inspektimin Tatimor.
 - **Mbledhja Nr. III - 15 Dhjetor 2015** – Diskutime mbi Informalitetin dhe Zbatimin e Kontratave.